



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË  
PUBLIKE TË KOSOVËS**


**NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH  
OF KOSOVA**



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE  
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,  
SEZONA 2024/2025 (JAVA 05-TË)**

**Simptomet e Gripit përfshijnë:**

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




**PËRMBLEDHJE**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2020/2021 -  
2024/2025**

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2024/2025 karakterizohet me numër më të lartë të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2023/2024 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të, 2024/2025 (Graf. 1).

Grafikoni.1




**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2024/2025 DHE PRAGU EPIDEMIK**

Nga fillimi i sezonës, 30 shtator 2024 deri më 2 shkurt 2025 (java e 5-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 66,312 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 7,312 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 84 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 5-të (27.01.2025-02.02.2025) janë raportuar 6,857 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 447 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 3 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).


**Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 5-të paraqitet në aktivitetin e lartë të qarkullimit dhe krahasur me javën e kaluar shënon rënie për 13.31%. (Graf.2)**


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Grip dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejë dhe Gjilanit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Prishtinës dhe Kamenicës. (Graf.3).


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara mirëpo vërehet një numër më i madh i rasteve të grup-mosha 15-64 vjeç (Graph.4). Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (3,286 raste) pastaj grup-mosha 15-64 vjeç (2,200 raste), 5-14 vjeç (1,160 raste) dhe grup-mosha 65+ vjeç (666 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4



**MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE**

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2024/2025 deri me 5 shkurt 2025, janë testuar gjithsej 3,166 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 1,585 (50.06%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 1,581 (49.93%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 11 prej tyre (0.69%).


Nga 1,581 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 449 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 28.39 %). Sipas tipit: me Influcencë A (283 raste apo 17.9%) dhe Influcencë B (166 raste apo 10.49%), sipas komunave: komuna e Prishtinës (145 raste), Mitrovicë (102 raste), Fushë Kosovë (33 raste), Podujevës (19 raste), Malishevës (18 raste), Vushtrri (17 raste), Pejës (16 raste), Lipjanit (15 raste), Drenas (14 raste), Ferizaj (13 raste), Obiliq (12 raste), Skenderaj (9 raste), Suharekë (5 raste), Rahovec (4 raste), Shtime (4 raste), Gjilan (4 raste), Klinë (4 raste), Gjakovë (3 raste), Prizren (4 raste), Viti (3 raste), Istog (2 raste), Hani i Elezit (2 raste) dhe me një rast komuna e Dragashit, kurse sipas grup-moshës: 0-4 vjeç (148 raste), 5-14 vjeç (124 raste), 15-29 vjeç (59 raste), 30-44 vjeç (32 raste), 45-60 vjeç (43 raste) dhe 60+ (43 raste).

Gjatë javës së pestë (27.01.2025-02.02.2025), në departamentin e Epidemiologjisë, nga laboratorët private, janë raportuar gjithsej 43 mostra të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga 43 mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 142 mostra me RSV, 100 mostra me Human Rhinovirus, 64 mostra me Human Adenovirus, 10 mostra me Parainfluenza Virus dhe 7 mostra Metapneumovirus.


Nga 142 rastet pozitive në RSV (8.98%): 122 prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 11 raste i takojnë grup-moshës 5-14 vjeç, 15-34 vjeç (2 raste), 51-64 vjeç (2 raste) dhe 65+ vjeç (5 raste), kurse sipas komunave: Prishtinë (60 raste), Fushë Kosovë (15 raste), Podujevë (14 raste), Vushtrri (9 raste), Drenas (7 raste), Ferizaj (4 raste), Obiliq (4 raste), Lipjan (4 raste), Malishevë (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Gjilan (3 raste), Klinë (3 raste), Shtime (2 raste), Kaçanik (2 raste), Vushtrri (2 raste), Suharekë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunitat : Gjakovë, Skenderaj, Pejë, dhe Prizren.

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 248 raste (55%), me subtipin AH3 janë 30 raste (7%), me subtipin AH1N1 janë 5 raste (1%), Influcencë B Victoria 9 raste (2 %) dhe Influcencë B të pasubtipizur janë 157 raste (35%).

Grafikoni.6



## AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor dhe sanitar të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

## MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit është në nivel të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe huthja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

**Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut**

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Vaksinimi kundër gripit sezonal bëhet në muajt tetor–dhjetor.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

## VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori 2024 deri me 10 janar 2025 janë administruar 64,011 doza. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 42,844 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 19,687 me sëmundje kronike, 1,446 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 31 fëmijë (0-5 vjeç).

## HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 33 raste me ARI, 13 raste me ILI, 2 raste me Influcë B dhe 3 raste me SARI.

Nga Klinika Infektive përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse deri më 2 shkurt 2025, janë raportuar 4 raste të vdekjes me Influcencë A. Të gjitha rastet janë të gjinisë mashkullore, i përkasin grup-moshës mbi 60 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

### INFLUENCA SEZONALE JAVA 05/2025 NË EVROPË

Aktiviteti i gripit sezonal është në rënie në shumicën e vendeve të Europës, me një rritje të rasteve me Influcencë B. Shkalla e pozitivitetit ka rënë në 15.6%, krahasuar me javën e kaluar e cila ishte 27.4%. Kjo përqindje tregon rastet pozitive me Influcencë të cilët kanë shfaqur simptome dhe janë testuar. Numri i rasteve të të hospitalizuarve ka rënë në 7.13 raste për 100,000 banorë, krahasuar me javën e kaluar ku kishim 8.51 raste për 100,000 banorë.

Aktiviteti i sëmundjeve të ngjishme me gripin (ILI) në kujdesin primar ka treguar një rënie, ku prej 23.1 rasteve për 100,000 banorë sa kishte javën e kaluar, këtë javë janë shënuar 17 raste për 100,000 banorë.

Shkalla e pozitivitetit sa i përket Virusit Sinticial (RSV) ka rënë në të gjitha grupmoshat, në kujdesin primar, gjatë dy javëve të fundit. Numri i rasteve SARI me RSV janë fëmijë nën pesë vjeç dhe rreth 15% janë individë 65 vjeç e sipër. Shkalla e pozitivitetit ndërmjet rasteve SARI është aktualisht stabile dhe mbetet më e lartë tek fëmijët 0–4 vjeç.

Deri në fund të javës së 5-të, sipas grupeve të rrezikut u vaksinuan 39.7% raste të grup-moshës mbi 65 vjeç, 34.8% gra shtatzëna, 41.4% fëmijë 2 vjeç dhe 43.2% për fëmijë 3 vjeç.

Sa i përket aktivitetit të SARS-COV-2, në shumicën e shteteve u shënuan trende të qëndrueshme ose në rënie.

**Burimi:** <https://www.ecdc.europa.eu/en/publications-data/communicable-disease-threats-report-24-31-january-2025-week-5>